



SENATI

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Prizren, më: 08.06.2021

Mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 42 të Statutit të Universitetit sipas Nr. 04-V-621 dt. 30 maj 2013, si dhe në zbatim të rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UUHP nr. prot. 01-161, respektivisht neni 15, pika 4, 5 dhe 6 në mbledhjen e mbajtur përmes postës elektronike zyrtare me datën: 08.06.2021, vendosi dhe nxori këtë

V E N D I M

- I. Konkursi i shpallur nga Senati i UUHP, i datës: 03.08.2020, me nr. prot: 01-167, ka përfunduar në kontest të afatit ligjor të paraparë sipas rregullores nr. 01-161, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.
- II. Anulohet pika katërt (4) e Konkursit për Fakultetin Ekonomik, sipas rregullores së lartcekur.
- III. Kjo pikë e konkursit e specifikuar si në pikën II të këtij vendimi, duhet të rishpallet në përputhje me legjislacionin në fuqi, në afatin optimal.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Senati i Universitetit të Prizrenit ka shpallur Konkurs për emërim, riemërim dhe avancimin e personelit akademik në UUHP, me datë: 03.08.2020, me nr. prot: 01-167. Duke pasur parasysh gjendjen e krijuar për shkak të Pandemisë Covid-19 si dhe duke u bazuar në zbatimin e Rregullores për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UUHP, respektivisht neni 15, pika 4 dhe 5 e kësaj rregulloreje, si dhe parregullësive procedurale të shkaktuara që nga shpallja e Konkursit e deri më tani, pas mbajtjes së mbledhjes përmes postës elektronike zyrtare, u mor vendim që të anulohet pika katërt e Konkursit për arsye të tejkalimit të afatave ligjore të parapara në rregulloren në fjalë, e njëjta pikë e Konkursit duhet të rishpallet sipas kërkesës së njësisë akademike përkatëse, duke u bazuar në rregulloren për procedurat përzgjedhëse për emërim, riemërim dhe avancimin e personelit akademik në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren (nr. 01-161, neni 15, pika 6).

Prandaj mbi këtë bazë, Senati i Universitetit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Keshille Juridike: Kunder këtij vendimi lejohet ankesa ne organet kompetente, ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

Menaxhmentit;

Njësisë Akademike;

Zyrës së Personelit, Arkiv dhe Ueb

Kryesues i Senatit
Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj